

# Pakoja e Ringjalljes Ekonomike



**Ministria e  
Financave, Punës  
dhe Transfereve**

# Masat

01. Mbështetja e Punësimit
02. Ringjallja e Ekonomisë dhe Prodhimit
03. Mbështetja për familjen
04. Mbështetja për publiken
05. Investimi në infrastrukturë dhe ambient



# Pakoja e Ringjalljes Ekonomike

## 4 synime të agreguara:

- 1.** Punësimi dhe formalizimi i ekonomisë, me fokus parësor në fuqizimin e rolit të gruas dhe të të rinjve në ekonomi;
- 2.** Përmirësim i strukturës së përbërjes së PBB-së përmes favorizimit të sektorëve të caktuar ekonomikë, sidomos në sferën e prodhimit dhe përmirësimit të bilancit tregtar të vendit;
- 3.** Rritje e balancuar dhe gjithëpërfshirëse ekonomike, duke u përkujdesur që e njëjta të shoqërohet edhe me përmirësim të indikatorëve kyç të mirëqenies;
- 4.** Ruajtja e qëndrueshmërisë afatgjatë dhe minimizimi i rreziqeve fiskale të vendit, përmes mbajtjes nën kontroll të rritjes së borxhit publik në vend, dhe koordinimit më të mirë me komunitetin e donatorëve për të siguruar maksimumin e përfitimit të ekonomisë dhe amvisërive.

Shuma e përgjithshme e Pakos së Ringjalljes Ekonomike është 420 milionë euro, ku financimi nga buxheti është 190 milionë euro, ndërsa 230 milionë euro tjera janë financim nga huamarrja.

Në kuadër të masave dhe veprimeve për ringjalljen ekonomike të vendit është edhe emetimi i Bonove të Diasporës, të cilat mjete do të përdoren për financimin e këtyre masave.



# 1 Mbështetja e Punësimit

50 milionë EUR

Prioriteti i parë i Qeverisë sonë është punësimi dhe kësaj i qëndrojmë prapa edhe me politika e vendime. Në funksion të këtij prioriteti, në kuadër të Pakos së Ringjalljes Ekonomike do të ndajmë 50 milionë euro për krijimin e vendeve të reja të punës, duke mbështetur në mënyrë të drejtpërdrejtë punëkërkuessit.

**1.1 Rikthimi në punë i atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë – 10 mil EUR**

**1.2 Mbështetja për të punësuarit e formalizuar – 10 mil EUR**

**1.3 Mbështetja e punësimit të grave – 5 mil EUR**

**1.4 Skema e punësimit të garantuar për të rinjtë – 10 mil EUR**

**1.5 Trajnimi dhe punësimi në TI – 5 mil EUR**

**1.6 Mbështetja e punësimit të personave me nevoja të veçanta – 5 mil EUR**

**1.7 Skema e granteve për zanatet – 5 mil EUR**



# 2 Ringjallja e Ekonomisë dhe Prodhimit

108 milionë EUR

Në kuadër të nismës globale për të rindërtuar ekonomitë më mirë se ç'ishin, do të investojmë 108 milionë euro që do të dedikohen për investime në teknologji e inovacion, prodhim dhe eksport, por pa harruar as mbështetjen e bizneseve që u goditën më së shumti nga pandemia.

**2.1 Subvencionimi i kredive investive – 30 mil EUR**

**2.2 Mbështetje bizneseve për qasje në financa – 43 mil EUR**

**2.3 Investime në TI dhe Inovacion – 10 mil EUR**

**2.4 Mbështetja e Eksportit – 10 mil EUR**

**2.5 Ringjallja e fshatit përmes bujqësisë dhe agro-turizmit – 10 mil EUR**

**2.6 Rikuperimi i hotelerisë dhe bizneseve të mbyllura – 5 mil EUR**



# 3 Mbështetja për familjen

50 milionë EUR

Me qëllim krijimin e një shoqërie të barabartë dhe për ngritjen e mirëqenies së qytetarëve, do të ndajmë 50 milionë euro për shtresat e cënueshme të shoqërisë.

Mbështetje kjo që synon sadopak lehtësimin e barrës që kanë pasur këto shtresa si pasojë e pandemisë.

**3.1 Mbështetja për familjet që kanë humbur kryefamiljarin – 4 mil EUR**

**3.4 Kuponë ushqimi për familjet në nevojë – 4 mil EUR**

**3.2 Mbështetja për pensionistët dhe familjet me asistencë sociale – 17 mil EUR**

**3.5 Pagesa për lehonat e papuna – 3 mil EUR**

**3.3 Reformimi i Skemës së Asistencës Sociale – 12 mil EUR**

**3.6 Mbështetja e likuiditetit familjar – 10 mil EUR**



# 4 Mbështetja për publikën

112 milionë EUR

Rritja e cilësisë së shërbimeve publike, rrjedhimisht përmirësimi i mëtejshëm i mirëqenies qytetare, është njëra ndër prioritetet kryesore të Qeverisë sonë. Andaj, do të ndajmë 112 milionë euro për shërbime cilësore në shëndetësi, arsim, kulturë e sport.

**4.1 Mbështetja për shëndetësinë – 53 mil EUR**

**4.4 Mbështetja e sigurisë – 10 mil EUR**

**4.2 Mbështetja për Arsimin – 9 mil EUR**

**4.5 Mbështetja e mërgatës – 5 mil EUR**

**4.3 Mbështetja e Kulturës dhe Sportit - 5 mil EUR**

**4.6 Mbështetja e ndërmarrjeve publike – 30 mil EUR**



# 5 Investimi në infrastrukturë dhe ambient

100 milionë EUR

Nga buxheti i tërësishëm për investime kapitale, rreth 100 milionë euro janë të dedikuara për investime në projekte strategjike që kanë të bëjnë kryesisht me infrastrukturë rrugore e hekurudhore, si dhe me investime në ruajtjen e ambientit.

Në kuadër të ambientit jemi duke negociuar me institucione financiare ndërkombëtare edhe për investime tjera në fushën e efijencës dhe energjisë elektrike, dhe jemi në hulumtim edhe për mundësi tjera financimi nga grantet dhe donatorët. Po ashtu, në këtë aspekt ka edhe investime tjera që janë duke u bërë e që janë jashtë buxhetit, siç është rasti me investimin në filterët e TC Kosova B, investim ky që sillet rreth 90 milionë euro, ku shumica është grant nga fondet IPA të BE-së. Kjo do të përmirësojë dukshëm cilësinë e ajrit dhe jetën e banorëve në komunat përreth.



Ministria e Financave,  
Punës dhe Transfereve